



INSTITUTI NACIONAL DEMOKRATIK

PLANI GLOBAL I VEPRIMIT

---

**FITONI<sup>me</sup> GRATË**  
FORCONI PARTITË POLITIKE

## FITONI ME GRATË: FORCONI PARTITË POLITIKE

**B**ota është duke e lënë anash një resurs shumë të çmuar kohëve të fundit. Dhjetra mijëra gra të talentuara presin rastin për ta përdorur ekspertizën e tyre në jetën publike. Në të njëjtën kohë, gratë, janë të nënpërfaqësuar, në mënyrë dramatike, në pozita të lidërshiptit politik anë e mbanë botës.

Partitë politike – portat për pozita politike – janë çelësa për avancimin e pjesëmarrjes së plotë të grave në procesin politik. Nuk është e mjaftueshme për partitë që të themelojnë forumet e grave ose t'i vendosin gratë në fund të listave partiake. Ato duhen të zhvillojnë mundësi reale që gratë të marrin role udhëheqëse.

Më 9 -10 dhjetor Instituti Nacional Demokratik (NDI) ftoi në Washington D.C. një grup punues ndërkombëtar të grave lidere të partive politike nga 27 shtete për të identifikuar se si mund të punohet sa më mirë për të krijuar mekanizma në kuadër të partive politike për të rritur mundësitë për gratë. Takimi i quajtur Forumi Global 2003 "Fitoni me Gratë: Forconi Partitë Politike" synoi të krijonte ura në mënyrë që gratë të mund bëjnë ndryshime për ardhmërinë e shteteve të tyre.

Forumit analizoi strukturat e partive politike që kanë inkurajuar gratë për të marrë më tepër role aktive të lidërshiptit, rekrutimin e kandidateve dhe programet e trajnimit, përpjekjet të suksesshme për angazhimin më të madh të grave, mundësitë për mbledhjen e fondeve dhe për komunikim, si dhe rrugët për të ndikuar në politikat qeveritare. Nga ky studim pjesëmarrësit e forumit hartuan një Plan Global të Veprimit me rekomandime, nga të cilat do të përfitojnë edhe gratë, edhe partitë politike. Këto të fundit përfitojnë nëse bëhen organizata më gjithëpërfshirëse dhe tërheqëse për një masë më të madhe njerëzish.

Plani Global i Veprimit që paraqitet në vijim, është unik sepse fokusohet ekskluzivisht në partitë politike. Roli i grave në proceset demokratike është esencial për reformimin, përtrirjen dhe modernizimin e partive politike. Ne i inkurajojmë partitë që të ndërrmarin reforma të sinqerta për të rritur mundësitë që gratë të marrin role udhëheqëse, sikurse skicohet në Planin Global të Veprimit. Duke ofruar këto rekomandime praktike për të promovuar pjesëmarrjen e grave, të cilat partitë mund t'i bëjnë të vetat, Plani Global i Veprimit mund të shënojë fillimin e një përpjekjeje për reforma që do ta shndërrojë vendosjen e grave në role udhëheqëse në një prioritet. Ky Plan mund të ndihmojë përpjekjet e partive politike për të krijuar organizata më përfaqësuese dhe më të besueshme.

Më 10 dhjetor Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, 36 nënshkruet e para e lancuan publikisht Planin Global të Veprimit dhe shprehën përkushtimin e tyre për ta promovuar këtë Plan në partitë dhe shtetet e tyre. Ne shpresojmë që publikimi dhe shpërndarja e Planit do të ta rrisë numrin e nënshkruësve dhe do të rrisë më tej vullmin e iniciativës "Fitoni me Gratë".

Partitë politike dhe organizatat e shoqërisë civile mund ta shprehin përkushtimin e tyre ndaj Planit Global të Veprimit duke e vizituar faqen tonë të Internetit në [www.winwithwomen.ndi.org](http://www.winwithwomen.ndi.org). Mirëpresim partneritetin dhe pjesëmarrjen tuaj aktive në këtë përpjekje të rëndësishme.

Madeleine K. Albright

Kryesuese e NDI

## PLANI GLOBAL I VEPRIMIT

### FITONI ME GRATË: FORCONI PARTITË POLITIKE

**S**i liderë të partive politike, ne jemi të përkushtuar ndaj zhvillimit demokratik vibrant dhe ndaj partive politike të fuqishme. Ne besojmë se kyçja kuptimplotë e grave është kritike në arritjen e këtyre synimeve. Prandaj, ne theksojmë nevojën që partitë politike të përfshijnë një gamë sa më të gjerë grupesh shoqërore, të jenë më transparente dhe të përfaqësojnë sa më shumë grupe, duke i zgjeruar mundësitë për pjesëmarrje të grave në politikë dhe në role udhëheqëse. Partitë politike janë organizata unike që bashkojnë interesat e popullit dhe kërkojnë të fitojnë pushtet (të hyjnë në qeveri) për të vënë në jetë politika që u përgjigjen këtyre interesave. Partitë njëkohësisht janë baza vendimtare për trajnimin e liderëve të ardhshëm qeveritarë dhe përfaqësojnë një rrugë kritike për avancimin e të drejtave të barabarta dhe mundësive për gratë dhe vajzat në shoqëri.

Shumë nga partitë politike kanë ndërmarrë reformat e nevojshme për t'iu përgjigjur sfidave që janë në rritje e sipër, duke përfshirë edhe apatinë e publikut, çështjen e besueshmërisë dhe të rëndësisë që kanë partitë politike në raport me shqetësimet e njerëzve. Pjesëmarrja e grave në këto reforma është kritike. Disa parti politike punojnë me zell për të rritur rolin e grave si votuese, si udhëheqëse partiake, si aktiviste dhe si kandidatë për poste të zgjedhura. Ne i përshëndesim ata udhëheqës partish që na përkrahin. Udhëheqja e tyre është çelësi për këtë përpjekje. Megjithatë, duke e parë në një perspektivë globale, barazia vazhdon të mbetet një synim i largët. Në shumë shtete dhe parti gratë janë të përjashtuar nga vendimarrja në një masë të madhe. Në disa shtete grave iu mohohet e drejta për të votuar dhe për të marrin pjesë në zgjedhje. Gratë e përbëjnë mbi 50% të popullatës botërore, ndërsa ato përbëjnë vetëm 15% të pozitave në qeveritë kombëtare.

Si liderë të partive politike ne jemi të vendosur të punojmë brenda partive tona që t'i konfrontojmë pengesat që e dekurajojnë

pjesëmarrjen e plotë politike të grave. Ne, gjithashtu, jemi të përkushtuar për të krijuar një kulturë globale politike, e cila përkrah përpjekjen tonë nëpërmjet partneritetit me shoqërinë civile dhe punës me media. Partitë tona duhen të vazhdojnë dhe t'i përshpejtojnë përpjekjet e tyre të deritanishme për të komunikuar me sa më shumë votuese femra; për të rekrutuar dhe trajnuar gra dhe vajza si lidere të partive politik, aktiviste dhe kandidatë; për të siguruar resurse për kandidatet femra dhe për të bërë të sigurt se kandidatët femra dhe meshkuj trajtohen në mënyrë të barabartë. Partitë politike, gjithashtu, duhet t'i edukojnë qytetarët rreth rëndësisë së barazisë në mes të femrave dhe meshkujve në sferën publike.

Në të njejtën kohë pjesëmarrja më e gjerë e grave dhe vajzave luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet për luftimin e korrupsionit dhe rritjen e stabilitetit politik në shoqëri, si dhe për vazhdimësinë e partive politike. Ne gjithashtu besojmë se pjesëmarrja e grave do të forcojë përgjegjësinë, transparencën dhe integritetin e partive politike. Studimet e kohëve të fundit tregojnë se korrupsioni zvogëlohet kur rritet pjesëmarrja e grave dhe vajzave në politikë dhe shoqëri. Sa më tepër gra dhe vajza që marrin pjesë në jetën politike - si votuese, si lidere të partive politike apo ai zyrtarë qeveritarë -, aq më tepër politikat publike reflektojnë shqetësime dhe perspektivën e grave dhe të vajzave.

Ne përkrahim tri dokumente themelore që përcaktojnë standardin ndërkombëtar për përcaktimin e barazisë në mes të femrave dhe meshkujve, dhe avokojnë për trajtimin e barabartë të tyre në jetën politike dhe publike: Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË), Platforma e Veprimit të Kombeve të Bashkuar (KB) në Beijing dhe Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të KB. Diskutimi ynë i përbashkët për heqjen e pengesave për pjesëmarrjen e plotë të grave dhe vajzave, ne do të fokusohemi në temat vijuese:

# 1

## **Heqja e kufizimeve për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë, duke përfshirë kufizimet mbi të drejtën për të votuar dhe për t'u kandiduar**

- Të shfuqizohen të gjitha kufizimet që nuk vlejnë në mënyrë të barabartë për femrat dhe meshkujt sa i përket votimit apo kandidimit për zgjedhje, përveç rasteve kur ato janë masa të përkohshme që promovojnë një pjesëmarrje më të madhe të femrave në politikë.
- Të vendoset një politike e tolerancës zero ndaj të gjitha formave të dhunës politike, posaçërisht ndaj dhunës dhe shqetësimit ndaj grave si votuese, kandidatë dhe aktiviste partiake.
- Të sigurohet siguria fizike e aktivisteve femra të partisë, kandidatëve dhe zyrtareve të zgjedhura, duke krijuar një vend të sigurtë ku femrat politikane dhe familjet e tyre mund të strehohen në rast se kërcënohen.
- Të merret në konsideratë krijimi i mekanizmave që përkrahin dhe mbrojnë gratë, atëherë kur ato fitojnë vizibilitet politik apo ndonjë pozitë politike. T'u ofrohen grave trajnime se si duhet të reagojnë ndaj sulmeve personale në media dhe/ose sulmeve ndaj anëtarëve të familjes. Të ndërtohen rrjetëzime që ndihmojnë me reagime të shpejta në raste të incidenteve të këtuilla.

# 2

## **Rritja e numrit të grave dhe vajzave si zyrtare të zgjedhura në nivelin kombëtar, në nivel të provincës dhe lokal.**

- Të përfshihet promovimi i femrave kandidatë në politikat zyrtare të partive politike. Të inkurajohen gratë dhe vajzat që të garojnë për poste në nivelet kombëtare, regjionale dhe lokale duke krijuar plane strategjike për rekrutimin, trajnimin dhe përkrahjen e kandidatëve femra.

- Të rekrutohen gra dhe vajza që të kandidojnë për poste në administratën publike në vendbanimet urbane dhe rurale.
- Të shqyrtohet mundësia për të krijuar mekanizmat e duhur për ngritjen e grave dhe vajzave si kandidatë dhe si zyrtare të zgjedhura, duke përfshirë edhe vendosjen e grave dhe vajzave në krye të listave partiake, si dhe kandidimin e tyre në zona ku ekziston mundësia që ato të fitojnë. Kuotat, në rrethana të caktuara, mund të luajnë një rol me rëndësi posaçërisht aty ku gratë dhe vajzat janë praktikisht të lëna jashtë sistemit politik.
- Të sigurohet përkrahjes reale financiare për kandidatet femra. Kandidatët meshkuj dhe femra që kanë mundësi afërsisht të barabarta për të fituar në zgjedhje, duhen të kenë qasje të barabartë në resurset partiake.
- Të ofrohen trajnime mbi aftësitë e specializuara për fushatën zgjedhore, trajnime që u përgjigjen nevojave të grave, duke përfshirë zhvillimin e politikave, teknikat e debatimit, organizimi dhe puna në kuadër të rrjeteve, avokimi, të folurit në publik, lidërshipi, media, organizimi në terren, planifikimi strategjik, ndërtimi i vetbesimit dhe grumbullimi i fondeve. Të përfshihen gjithashtu edhe trajnime mbi mesazhin dhe mediat, trajnime këto që ju ndihmojnë grave dhe vajzave të duken më të sigurta, më të qarta dhe të përgatitura mirë.
- Të mbahet një bazë e të dhënave për gratë dhe vajzat që kanë kualifikimin e nevojshme për t'u kandiduar në pozita të zgjedhura dhe në pozita politike të emëruara.
- T'u ofrohet ndihmë kandidatëve femra për të zhvilluar aftësi në fusha që kanë qenë tradicionalisht të dominuara nga meshkujt, si buxheti dhe marrëdhëniet e jashtme, në mënyrë që gratë dhe vajzat të jenë të afta për t'u marrë me të gjitha çështjet e politikave.

- Të krijohen programe që mundësojnë përcjelljen e përvojës nga gra politike në pozita të larta në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar gratë dhe vajzat që aspirojnë të bëhen politike, për kandidatet dhe zyrtaret e reja të zgjedhura. Të inkurajohen gratë dhe burrat që të bëhen mentorë për gratë dhe vajzat që janë në rrugë për t'u bërë udhëheqëse, sidomos për të promovuar përfaqësimin e grave dhe vajzave mbrenda dhe jashtë partisë.
- Të vlerësohen mundësitë për rritjen e përfaqësimit të grave dhe vajzave në fusha të tilla si tranzicionet politike, proceset paqësore, proceset e reformave zgjedhore, etj. Lideret femra duhet t'i shfrytëzojnë këto mundësi për të promovuar reforma.
- Aty ku ekziston mundësia, të shfrytëzohen instrumentet dhe koventat ndërkombëtare si mjete për të fituar përkrahjen në vend për rritjen e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në politikë.
- Të ndërtohen marrëdhënie të forta me organizata të shoqërisë civile për përkrahjen e fushatave të avokimit të cilat e promovojnë përfaqësimin e grave dhe vajzave.
- Të edukohen gazetarët mbi rëndësinë e grave dhe vajzave në politikë dhe qeverisje.
- Të përkrahen kandidatet femra në kërkimin e metodave jotradicionale dhe kreative të komunikimit në situata ku ato ballafaqohen me pengesa strukturale në qasjen në media, sikurse që janë mediat shtetërore.
- Të përkrahen përpjekjet e kandidateve femra që të kërkojnë trajnime jashtë partisë dhe të identifikojnë organizatat të cilat ndajnë vlerat e tyre dhe mund tu ndihmojnë në dërgimin e mesazhit të tyre.

### 3 Sigurimi i përfshirjes së grave dhe vajzave në pozita të rëndësishme udhëheqëse dhe në një masë të rëndësishme në partitë politike.

- Të sigurohet që gratë dhe vajzat të jenë të përfaqësuara në mënyrë të rëndësishme në organet vendimarrëse brenda partisë dhe pozita të lidërsipit në parti.
- Të hartohen planet e avokimit që promovojnë një masë kritike të së paku 30% për përfaqësimin e grave dhe vajzave në partitë politike. Të sigurohet që gratë dhe vajzat vendosen në ato vende në listat e kandidatëve ku ka mundësi të fitojnë dhe që gratë dhe vajzat të jenë të përfaqësuara në pozita të lidërsipit dhe në organet vendim-marrëse të partive.
- Platformat dhe manifestot e partive të merren me çështjet gjinore. Të punohet me liderë partiakë - meshkuj dhe femra - që të diskutojnë çështje që lidhen me shqetësimet dhe prioritetet e votueseve femra.
- Të edukohet anëtarësia e partisë mbi rëndësinë e kyçjes së grave dhe vajzave në pozita të lidërsipit politik.
- Të themelohet një komision për mundësitë e barabarta (si organ mbikqyrës dhe implementues), i cili verifikon që rregulloret e partisë që merren me barazinë mes burrave dhe grave, respektohen. Një përqindje gati e barabartë burrash dhe grash duhet të shërbejnë në këtë komision.
- Të merret në konsideratë mundësi për të vendosur kuota brenda partisë, për një periudhë të caktuar për të cilën është rënë dakord më parë, për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet partiake.

- Të përvetësohen rregullat demokratike dhe transparente në kushtetutat dhe rregulloret e partisë dhe të sigurohet implementimi i tyre. Të promovohet transparenca në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për të vendosur kritere të qarta dhe të kuptueshme të selekcionimit.
- Të ofrohet trajnim dhe përkrahje financiare degëve, grupit apo komisioneve të grave brenda partisë. Këto organizma shërbejnë si forume për gratë dhe vajzat që të kontribuojnë në mënyrë të rëndësishme në hartimin e politikave dhe procedurave partiake, në selekcionimit e lidershit të partisë dhe në përzgjedhjen e kandidatëve. Këto organizma duhet po ashtu të ofrojnë mundësi për të diskutuar çështjet shqetësuese për gratë, të bëhen mentorë, të ofrojnë mundësi për rrjetëzim dhe të ndërtojnë aftësitë kritike të vajzave dhe grave për hartimin e politikave dhe për avokim e jo thjesht të shërbejnë si një shenjë e thjeshtë e përfaqësimit të grave dhe vajzave në parti.
- Të analizohen sistemet zgjedhore dhe legjislacioni egzistues për të kuptuar ndikimin e tyre në pjesëmarrjen politike të grave dhe vajzave. Të hartohen plane për t'iu përgjigjur pengesave të identifikuar gjatë reformave kushtetuese, legjislative e rregullatore.
- Të punohet në rritjen e besueshmërisë dhe suksesit të politkaneve femra duke e inkurajuar partneritetin në mes të anëtarëve femra të partisë dhe liderëve të partisë.
- Të shtohen kontaktet me gratë dhe vajzat votuese duke e përdorur platformën partiake për zhvillimin e mesazhit për dhe mbi femrat. Të krijohet një kabinet informativ në selinë e partisë për të ruajtur materiale mbi iniciativat për të kontaktuar më shumë me votueset femra..
- Të inkurajohen Partitë Ndërkombëtare për të implementuar strategji që nxisin partitë anëtare të rrisin numrin e aktivisteve

femra në parti, të kandidatëve dhe zyrtareve të zgjedhura.

- Të ndihmohen anëtarët e partisë, kandidatët dhe zyrtarët e zgjedhura që të kenë qasje në burimet tradicionale të mediave si në radio, shtyp dhe television. Të lehtësohen marrëdhëniet në mes të grave politkane dhe reporterëve, posaqërisht reporterëve femra.
- Gjatë përpilimit të mesazheve për media dhe në zgjedhjen e zëdhënësit të partisë, të përfitohet nga perceptimi popullor se gratë dhe vajzat janë të sinqerta, të drejta dhe të kujdesshme.
- Të shfrytëzohet teknologjia, mbrenda partisë dhe qeverisë, për t'iu përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave dhe për të informuar mbi politikat dhe programet e qeverisë.

## 4

**Inkurajimi i pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendim-marrje në qeveri dhe avokimi për një legjislacion që siguron barazinë e plotë mes burrave dhe grave.**

- Të avokohet për emërimin e më tepër grave dhe vajzave në pozita në nivel të kabinetit qeveritar dhe në zyret e tjera të larta në kuadër të qeverisë. Të identifikohen gra dhe vajza me ekspertizë politike për pozita në nivele të larta në qeveri dhe të inkurajohen ato që të zhvillojnë marrëdhënie me gra dhe burra që mund të jenë përkrahës të emërimit potencial të këtyre grave dhe vajzave në këto poste.
- Të diversifikohen portfoliot e grave ministre ashtuqë ato nuk do të jenë të kufizuara vetëm në çështjet sociale.
- Të zhvillohen programe për trajnim, duke përfshirë trajnime mbi aftësitë udhëheqëse, me qëllim që të përgatiten gratë dhe vajzat për përmbushjen e rolit të tyre si përfaqësuese të qeverisë.

- Të implementohen masa për t'i stimuluar gratë dhe vajzat që ato të kërkojnë pozita në shërbimin publik, dhe të promovohen gratë dhe vajzat në kuadër të strukturave udhëheqëse të shërbimit civil, të ministrive dhe agjencioneve qeveritare.
- Të formohen grupet parlamentare të grave në organet legjislativë për të punuar mbi çështjet me interes për gratë si dhe në koalicione që i kalojnë vijat partiake.
- Të promovohet legjislacioni që siguron barazinë e plotë të grave dhe burrave, duke përfshirë ndalimin e diskriminimit ndaj grave dhe vajzave në punësimin dhe promovimin mbrenda shërbimit publik.
- Të themelohet, forcohet dhe financohet një zyre për gratë në secilin departament, ministri apo agjencion për të zhvilluar plane veprimi dhe propozime legjislativë që merren me nevojat e grave dhe vajzave.
- Të zhvillohen dhe të vihen në punë mekanizma kombëtarë për buxhetim që sigurojnë se agjencionet qeveritare janë të financuara në mënyrë adekuate për të promovuar dhe për t'ju përgjigjur iniciativave të fokusuara në gratë dhe vajzat.
- Të gjinden dhe të shpërndahen të dhënat mbi pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në zyret publike në nivelet kombëtar, provincial dhe lokal (p.sh., nëpërmjet kartave raportuese mbi numrin e femrave në zyret qeveritare). Të caktohet një agjencion apo departament qeveritar që të mirëmbajë informatat dhe të ndërmarrë çdo vit përpjekje për përmirësimin e statistikave. Qeveritë gjithashtu duhen të marrin në konsideratë edhe vlerësimet e pavaruara të organizatave joqeveritare mbi këtë çështje.
- Të edukohen qytetarët për rëndësinë e grave dhe vajzave në shërbimin qeveritar nëpërmjet mediave dhe mjeteve tjera të edukimit qytetar.
- Të krijohet legjislacioni për të siguruar kujdesin ndaj fëmijëve, ndaj të vjetërve, kujdesin familjar dhe politikat të tjera që përkrahin gratë që punojnë në agjencionet qeveritare.
- Të krijohen partneritetet me organizatat joqeveritare për edukimin e lidereve femra dhe të ndërtohen koalicione për iniciativa legjislativë.
- Të krijohen mekanizma në qeveri për të matur dhe për t'ju përgjigjur “ndarjes digjitale” mes femrave dhe meshkujve.

Si liderë të partive politike, ne angazhohemi se do të vazhdojmë të avokojmë për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave dhe se do të punojmë me liderë të tjerë të partive - meshkuj dhe femra - për të bërë të sigurt se partitë tona bëjnë çdo gjë të mundur për t'i thyer barrierat për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave.